



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-055
Prishtinë, më 3 mars 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-31

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 3 MARS 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Slobodan Petroviq, kurse mungoi (me arsye) Ibrahim Gashi.

Nga Grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Muferra Sinik, ndërsa munguan Bojan Stojanoviç dhe Slavisha Pekoviç.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga NDI: Rinor Beka; dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje. Ai propozoi edhe gjashtë pika shtesë.

Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 shkurt 2009,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 shkurt 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 shkurt 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **vendosi** që seanca plenare e radhës të mbahet **më 12 mars 2009**, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi,
10. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit në Komisionin për Ankesa Pronësore, dhe
11. Propozimi për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

3.1 Propozimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për emërimin e një anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta shqyrtojë propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime në seancën plenare më 12 mars 2009.

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për radhitje në seancë plenare të Peticionit të Shoqërisë Civile

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione që të organizojë takim të përbashkët me Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me përfaqësuesit e Ministrisë së Energjetikës dhe të Minierave dhe me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë për të shqyrtuar Peticionin e Shoqërisë Civile kundër ngritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe pastaj të hartojë Raportin me rekomandime për procedimin e mëtejshëm të këtij peticioni.

3.3 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime publike, administratë lokale dhe media për përshpejtimin e procedurës për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve në Bordin e RTK-së,

Kryesia, pasi shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia ripërsërit kërkesën që partitë politike, të përfaqësuara në Kuvend, të propozojnë nga një deputet për anëtar në Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve në Bordin e RTK-se, në afatin sa më të shkurtër të mundshëm.
2. Komisionin ad hoc duhet që Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime për përzgjedhjen e kandidateve për anëtarë në Bordin e RTK-se, në pajtim me nenin 23.1 dhe 23.2 d) të Ligjin nr. 02/L-47 për Radio -Televizionin e Kosovës.

3.4 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për përshpejtimin e procedurës për emërimin e anëtarit të Këshillit në Komisionin e Pavarur për Media

Kryesia, pasi shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia ripërsërit kërkesën që gupet parlamentare t'ia propozojnë Kuvendit një kandidat për anëtar në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media, sipas nenit 4.3 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, ne afatin sa më të shkurtër të mundshëm.
2. Propozimet duhet të bëhen në pajtim me Rregullat procedurale të miratuara nga Kuvendi i Kosovës e të bashkangjitura këtij përfundimi.

3.5 Njoftimi me mbylljen e konkursit për zgjedhjen e një anëtari në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

Kryesia, pasi u njoftua për procedurat e mbylljes së konkursit për një anëtar në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës,

V e n d o s i

1. Që Komisioni ad hoc, i formuar me vendim të Kuvendit, datë 18 shtator 2008, të funksionalizohet për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.
2. Komisioni ad hoc, në bazë të Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, duhet t'i shqyrtojë kandidaturat e paraqitura për pozitën e anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga radha e komunitetit serb dhe Kuvendit t'ia paraqes Raportin me rekomandime.

3.6 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Naim Rrustemi për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar në Ukrainë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

Lejohet kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit të deputetit Naim Rrustemi, për pjesëmarrje në Studimet e avancuara për fushën e sigurisë, që do të mbahen në Ukrainë, prej 12 deri më 16 mars 2009.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Rregullore të Punës për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Komisionit për Rregullore të Punës së Kuvendit në Shqipëri, prej 08. 03. 2009 deri më 11. 03. 2009, në përbërje të deputetëve: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Suzanë Novobërdali, Hydajet Hyseni dhe Besa Gaxheri , Eshref Vishi, këshilltar i Kryetarit të Kuvendit, si dhe Ismet Krasniqi, Daut Beqiri dhe Nur Çeku, nga Administrata e Kuvendit.
2. Shpenzimet e akomodimit për tre deputetë i mbulon organizatori, ndërsa të gjitha shpenzimet e tjera të delegacionit përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Slobodan Petroviq për lejimin e udhëtimit zyrtar në Slloveni

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetit Slobodan Petrović në Slloveni prej datës 04. 03. deri më 07.03. 2009.
2. Shpenzimet udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë (30%) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

3.9 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Mufera Sinik për lejimin e udhëtimit zyrtar në Turqi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes Mufera Sinik në Turqi prej datës 05.03. deri më 09.03. 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë (30%) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

3.10 Shqyrtimi i kërkesës së GP SLS për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Shërbime publike

Kryesia vendosi që kërkesa e Grupit Parlamentar të SLS t'i procedohet seancës plenare më 12 mars 2009.

3.11 Njoftimi me Rekomandimet e Komisionit për Punë te Brendshme dhe Siguri

Kryesia u njoftua me Rekomandimet e Komisionit për Punë te Brendshme dhe Siguri lidhur me procesin e shpërbërjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Në diskutimin e kësaj çështjeje, u tha se komisionet parlamentare gjatë shqyrtimit të disa çështjeve shpesh po e tejkalojnë fushëveprimin e përgjegjësive të tyre. Andaj, Kryetari i Kuvendit, në takimin që do ta ketë me kryetarët e komisioneve parlamentare, më 6 mars 2009, do ta diskutojë edhe këtë çështje, si dhe për përshpejtimin e procedurave për shqyrtimin e projektligjeve me të cilat i ka ngarkuar Kuvendi.

3.12 Njoftimi me Raportin e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga vizita në Republikën e Shqipërisë

Kryesia u njoftua me Raportin e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili kishte marrë pjesë në Konferencën e Kartës së Adriatikut, që ishte mbajtur në Shqipëri prej 23 deri më 24 shkurt 2009.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale